

DEKLARATË PUBLIKE – PËR MBROJTJEN E HAPËSIRËS QYTETARE, LIRISË SË SHPREHJES DHE DEBATIT DEMOKRATIK

Drejtuar:

- *Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;*
- *Komisioneres Evropiane për Zgjerimin, znj. Marta Kos;*
- *Ambasadorit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, z. Silvio Gonzato;*
- *Kryetarit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, ambasadorit Michel Tarran;*
- *Drejtueses së Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, znj. Giulia Re;*
- *Avokatit të Popullit të Republikës së Shqipërisë;*
- *Autoritetit të Mediave Audiovizive;*
- *Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;*
- *Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;*
- *si dhe përfaqësive diplomatike dhe partnerëve ndërkombëtarë.*

Ne, organizatat e shoqërisë civile, mediat e pavarura dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut nënshkruese të kësaj deklarate, shprehim shqetësimin tonë për përsëritjen e fushatave të denigrimit dhe të sulmeve publike ndaj gazetarëve, aktivistëve, organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve që ushtrojnë të drejtën e tyre për t'u shprehur, për të protestuar apo për të marrë pjesë në debatin publik.

Nuk bëhet fjalë për raste të izoluara apo për mosmarrëveshje mes individësh. Bëhet fjalë për një model komunikimi që po shfaqet gjithnjë e më shpesh dhe që synon ta zhvendosë debatin nga çështjet me interes publik te sulmet ndaj individëve që i ngrenë ato.

Në vend të debatit mbi argumentet, vihen në shënjestër personat. Në vend të diskutimit mbi faktet, vihen në dyshim motivet. Në vend të transparencës dhe llogaridhënies, përdoren insinuata, etiketime dhe narrativa që synojnë të diskreditojnë punën profesionale dhe angazhimin qytetar. Këto praktika nuk prekin vetëm individët e përfshirë; ato krijojnë një klimë presioni që dekurajon pjesëmarrjen në jetën publike dhe ngushton hapësirën qytetare.

Në javët e fundit, këto sulme kanë prekur organizata, gazetarë, aktivistë, mbrojtës të mjedisit dhe qytetarë të ndryshëm. Megjithëse objektivat ndryshojnë, modeli mbetet i njëjtë: përmes sulmeve personale, etiketimeve dhe narrativave denigruese synohet të shmanget debati mbi çështjet e ngritura dhe të ushtrohet presion ndaj kujtdo që zgjedh të marrë pjesë në jetën publike.

Ky model bëhet edhe më shqetësues kur përforcohet nga persona që ushtrojnë funksione publike. Në një shoqëri demokratike, zyrtarët publikë kanë jo vetëm të drejtën, por edhe përgjegjësinë për të marrë pjesë në debatin publik, duke respektuar standardet më të larta të komunikimit institucional. Përdorimi i autoritetit publik për të veçuar me emër aktivistë, gazetarë apo qytetarë dhe për t'i ekspozuar ata ndaj fushatave të denigrimit nuk është në përputhje me standardet demokratike që Shqipëria është zotuar të respektojë.

Respektimi i shtetit të së drejtës, lirisë së medias, lirisë së shprehjes, lirisë së tubimit paqësor dhe garantimi i një mjedisi mundësues për shoqërinë civile janë elemente themelore të një demokracie funksionale dhe pjesë e standardeve që shoqërojnë procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Organizatat e shoqërisë civile, gazetaria e pavarur, dhe aktivizmi qytetar nuk janë kundërshtarë të institucioneve. Përkundrazi, ato kontribuojnë në forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe besimit publik, duke luajtur një rol të domosdoshëm në funksionimin e një shoqërie demokratike.

Bashkëpunimi ndërmjet shoqërisë civile shqiptare dhe partnerëve ndërkombëtarë është një pjesë legjitime e zhvillimit demokratik të vendit. Përpjekjet për ta instrumentalizuar këtë bashkëpunim për të delegjitimuar organizatat e shoqërisë civile apo partnerët e tyre bien ndesh me parimet e pluralizmit, dialogut demokratik dhe bashkëpunimit ndërkombëtar mbi të cilat mbështetet edhe procesi i integritetit evropian të Shqipërisë.

Përballë këtyre zhvillimeve, ne mbetemi të vendosur të mos lejojmë që fushatat e denigrimit apo përpjekjet për intimidim të kufizojnë ushtrimin e lirive dhe përgjegjësiave tona qytetare, duke i bërë thirrje:

- Institucioneve shtetërore, të garantojnë në praktikë mbrojtjen e lirisë së shprehjes, lirisë së medias, të drejtës për tubim paqësor dhe një mjedis të sigurt për organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët që angazhohen publikisht.
- Zyrtarëve publikë dhe aktorëve politikë, të zhvillojnë një debat publik të bazuar në fakte dhe argumente, duke shmangur gjuhën denigruese, sulmet personale dhe çdo formë komunikimi që mund të nxisë stigmatizimin apo intimidimin e individëve.
- Mediave, të respektojnë standardet profesionale dhe Kodin e Etikës, të verifikojnë informacionin përpara publikimit.
- Partnerëve ndërkombëtarë, institucioneve të Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës, OSBE-së dhe përfaqësive diplomatike, të vazhdojnë të monitorojnë me vëmendje zhvillimet që lidhen me hapësirën qytetare, lirinë e medias dhe liritë themelore në Shqipëri, si pjesë e vlerësimit të standardeve demokratike dhe angazhimeve që vendi ka marrë në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Mbrojtja e hapësirës qytetare nuk është vetëm interes i organizatave të shoqërisë civile; ajo është një kusht për funksionimin e shtetit demokratik, forcimin e besimit publik dhe respektimin e standardeve evropiane që Shqipëria ka zgjedhur të ndjekë.

Nënshkruesit / Signatories:

1. Këshilli Shqiptar i Medias
2. Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë
3. Rjeti Erasmus Tirana
4. Qendra Amfora
5. Aleanca Kundër Diskriminimit LGBTI
6. Civil Rights Defenders, Shqipëri
7. Partners Albania
8. Komiteti Shqiptar i Helsinkit
9. Qendresa Qytetare
10. AWEN – Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
11. AWA – Albanian Women in Audiovisual
12. “Faktoje”
13. Shteg.org
14. Academy of Political Studies
15. Fondacioni “Së Bashku”

16. Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV)
17. *Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER)*
18. *Institute for Political Studies (ISP)*
19. Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim
20. CRCA Shqipëri
21. Drejtësi Sociale
22. Shoqata “Unë, Gruaja” – Pogradec
23. Forumi i Gruas – Elbasan
24. Shoqata “Gender, Paqe e Siguri” – Durrës
25. Rrjeti i Informimit dhe Qytetarisë Aktive
26. *Citizens Channel*
27. All Green Centre
28. Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore
29. ‘Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative’ Shqipëri
30. Together for Life
31. Qendra Res Publica